

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Avokati i Thaçit sugjeron Kuvendin t'ia heqë mbështetjen Speciales
ADRESA	https://www.koha.net/lajmet-e-mbremjes-ktv/avokati-i-thacit-sugjeron-kuvendin-tia-heqe-m-beshtetjen-speciales
BURIMI	koha.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 02:17:46 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 17:20:30 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	ab737651257a14473da876707bcd931a8f5e5a7dc81fe110a59e18c31a6d3545
TEKSTI	ee87a53c4731d88dffac2597ce3efe7ee4aca84ba16192d74e9314bdbcdd04ba
PAMJA	d897ddd40dc38967892526570a0546f29053ecfe1ac81b678795da6d5035be32

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	321cb847c8a3df515697942e98c48843bf31628ab4b2cd6653ae7ec0bf195e37
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	620a3e0ea5360256664d4fe0b9b06d4faf85ac171f0ef56a543d5c170249f92b
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/321cb847c8a3df515697942e98c48843bf31628ab4b2cd6653ae7ec0bf195e37>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

LAJMET E MBRËMËS

Avokati i Thaçit sugjeron Kuvendin t'ia heqë mbështetjen Speciales



Nga: Rinesa Qorri

16 shtator 2026 19:20

Shpërndaje në:



Klikoni këtu nëse dëshironi t'i lexoni lajmet e fundit dhe të përzgjedhura në kanalim tonë zyrtar në Viber

Të zhgënjyer me vendimin e sotëm të Gjykatës Speciale në Hagë janë shprehur avokatët mbrojtës të ish-krerëve të UÇK-së. Pas seancës, ku u dha verdikti për dënimin e katërshtes udhëheqëse të UÇK-së, avokati i ish-presidentit, Hashim Thaçi, ka sugjeruar që Kuvendi i Kosovës duhet të veprojë menjëherë

Dështim i drejtësisë është cilësuar vendimi dënues ndaj ish-udhëheqësve të UÇK-së nga avokatët e tyre mbrojtës.

I zhgënjyer nga vendimi, Pierre-Richard Prosper, avokat i ish-presidentit, Hashim Thaçi, ka sugjeruar që qysh nesër, Kuvendi i Kosovës duhet t'ia heqë mbështetjen Gjykatës Speciale me seli në Hagë.

“Kam goditur kokën time me grushte kur gjykatësi shqiptoi ‘në emër të popullit të Kosovës’. Ata nuk dëgjuan mbrojtjen. Parlamenti i Kosovës duhet ta shohë këtë. Sepse ky është partneritet mes BE-së dhe Parlamentit të Kosovës. Unë do e hiqja mbështetjen që nesër. Kosova duhet të marrë një vendim sovran. Në disa raste duhet të çohesh në këmbë dhe të marrësh një vendim”, ka thënë ai.

Avokati Prosper po ashtu u ka bërë thirrje NATO-s dhe Departamentit Amerikan të Shtetit që të shqyrtojnë nga afër vendimin e gjykatës.

Vërejtje të mëdha për vendimin ka dhënë edhe mbrojtja e Kadri Veselit, Rodney Dixon, teksa ka paralajmëruar dërgimin e çështjes në Apel.

“Gjatë gjithë procesit gjyqësor, në emër të z. Veseli, kemi theksuar qartë mungesën e provave për përfshirjen e tij në ndonjë rrëmbim, vrasje apo aktivitet kriminal gjatë luftës për lirinë e Kosovës. Fatkeqësisht, kjo nuk është një ditë e mirë për Kosovën. Nuk është një ditë e mirë as për sundimin e ligjit dhe as për të drejtën ndërkombëtare. Prandaj, ne do ta shqyrtojmë me shumë kujdes këtë aktgjykim të gjatë, të cilin sapo e kemi

Arbëri.

81 vjet burgim për katër ish-drejtesit e UÇK-së

Arbëri.

Qytetarët sërish mbledhen para EULEX-it, e gjuajnë me gurë e mjete piroteknike

Arbëri.

Dy protestues u shoqëruan në polici, njëri u ndalua për 48 orë

Kronikë.

Vdiq një 21-vjeçar, u godit nga vetura në fshatin Vlashnje

Futboll.

Humbje për Milanin në Ligën e Evropës

Futboll.

Tjetër goditje për Manchester Unitedin

pranuar, me qëllim që të paraqesim një apelim të fuqishëm dhe të vazhdojmë luftën për të dëshmuar pafajësinë e z. Veselit dhe për ta kthyer atë në shtëpi, në Kosovë”, ka theksuar ai.

Edhe



Arbëri • 15 o. më parë

Avokati i Thaçit: Po të isha si Kuvendi i Kosovës, do e zhbëja Gjykatën Speciale që nesër

I zhgënjyer është shprehur edhe avokati i Rexhep Selimit.

Avokatët mbrojtës e kanë cilësuar 16 shtatorin si ditë të zezë për drejtësinë ndërkombëtare.

#PIERRE-RICHARD PROSPER

#HASHIM THACI

#KADRI VESELI

#JAKUP KRASNIQI

#REXHEP SELIMI

#AVOKATET

Artikuj të ngjashëm



Arbëri • 8 o. më parë

Liderë shtetërorë e politikë thonë se e vërteta e luftës në Kosovë është ndryshe nga vendimi



Arbëri • 8 o. më parë

Familjarët e Thaçit, Krasniqit e Veselit besojnë në luftën e pastër të UÇK-së



Arbëri • 9 o. më parë

Procedurat e Apelit që duhen ndjekur mbrojtjet e ish-krerët e UÇK-së



Arbëri • 10 o. më parë

Çitaku: Aleatët historikë të Thaçit po thonë pranojeni vendimin - jo faleminderit

KOHA

Kjo faqe kontrollohet dhe menaxhohet nga KOHA. Të gjitha materialet në të, përfshirë fotografitë, janë të mbrojtura me copyright të KOHA-s dhe për to KOHA mban të drejtat e rezervuara. Materialet në këtë faqe nuk mund të përdoren për qëllime komerciale. Ndalohej kopjimi, riprodhimi, publikimi i paautorizuar qoftë origjinal apo i modifikuar në çfarëdo mënyre, pa lejen paraprake të KOHA-s. Shfrytëzimi i materialeve nga ndonjë faqe interneti a medium tjetër pa lejen e Grupit KOHA, në emër të krejt njësisë që e përbëjnë (Koha Ditore, KohaVision, Koha.net, Botimet KOHA, KOHA Print dhe ARTA), është shkelje e drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispozitave ligjore në fuqi. Të gjithë shkelësit e këtyre të drejtave do të ballafaqohen me ligjin.

Marketing

Politika e privatësisë

Kushtet e përdorimit

Udhëzimet për përdorimin e IA-së

Cilësimet e privatësisë dhe cookies

Përkthimi i përmbajtjeve në gjuhët tjera bëhet në mënyrë automatike dhe mund të ketë gabime!

+383 (0) 38 249 105 /

AL | EN | DE | FR | ES | GR | SR | TR | MK

Aneksi i ish-Radio Prishtinës (kati i parë) Xhorxh Bush p.n., 10000 Prishtinë

Shkarkoje aplikacionin e KOHËS



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.